

**AKT THEMELIMI  
I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

**SAIL YATCH HAKUNA MATATA**

Sot, më datë 05.02.2024, personalisht:

Emiliano Papa, atesia Bernardo Mario, shtetas italian, lindur ne Cassino (FR), Itali, dhe baunuese ne Via Madonna di Ponza, 04023 Formia (LT), Itali, lindur me 22.10.1973, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me karte identiteti me Nr. CA63918RE, me cilesine e ortakut themelues te shoqerise tregtare SAIL YATCH HAKUNA MATATA.

Përpilon këte akt themelimi të shoqërisë tregtare **SAIL YATCH HAKUNA MATATA sh.p.k.**, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Të themelojë Shoqërinë Tregtare **Sail Yatch Hakuna Matata SH.P.K.**, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri Sail Yatch Hakuna Matata SH.P. K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësish me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit Sail Yatch Hakuna Matata SH.P. K dhe ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4 Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria, në përputhje me dispozitat dhe kufizimet e ligjit, ka për objekt veprimtaritë e mëposhtme:

Transport detar dhe bregdetar te pasagjerëve me anije të përshtatëshme, transport te pasagjerëve në liqene të mëdhenj etj. kur përdoren lloje të ngajshme anijesh, anije për eskursione, turistike, taksi turistike ujore, etj. Dhënen me qera të anijeve turistike me ekuipazh për transport detar dhe bregdetar.

Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e anijeve.

#### **NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga Mjull Bathore, Nr.pas 945/8, Sauk, Tiranë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

#### **NENI 6 Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar eshte 100.000 (njeqind mijë) Lek dhe zotërohet nga ortaku themelues.

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

#### **NENI 7**

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare Sail Yatch Hakuna Matata SH.P.K zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Emiliano Papa, pjesemarrja me perqindje 100 %, 1 kuote, lloji i kontributit ne para 100.000 leke.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

#### **NENI 8 Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Ortaku i Vetem – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

#### **NENI 9 Administratori**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë te shoqërisë do të jenë Z. Emiliano Papa.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.



## **NENI 10**

Oratku mund të vendose me vullnetin e tij, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## **NENI 11**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

## **NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

## **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u get sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe pasi ortaku eshte njohës i gjuhës shqipe.

### **ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**Emiliano Papa**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Emiliano Papa". The signature is fluid and cursive, with "Emiliano" on the left and "Papa" on the right, separated by a vertical line.